REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 950-956/20
Datë/Datum. 27.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Blerina Huruglica ***Ekspert Shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***19.11.2020***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***27.11.2020***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.11.2020, **OE "Matcal Solutions"SHPK** dhe me datën 17.11.2020, **OE "Construmax"SHPK**, kanë parashtruar ankesë me nr: **950-956/19**, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Rregullimi i gardhit rrethues për parkun ekonomik në Lubizhdë të Prizrenit**" me nr. të prokurimit: **622-20-3261-5-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: **200 000,00** €.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim:
Data e njoftimit për kontratë: 29.06.2020,
Data e hapjes së ofertës: 20.07.2020 dhe Rivlerësimi: 30.10.2020,
Data e njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit: 31.08.2020,
Data e njoftimit të ofertuesve: 31.08.2020 dhe pas rivlerësimit- Njoftimi për anulim të A.P: 30.10.2020

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr.654-702/20 i dt:09.10.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Sa i përket pretendimeve të OE ankuesit të parë "Matcal Solutions"SHPK:

Me date 30.10.2020 kemi pranuar njoftimin per tenderuesin e elimiuar si dhe njoftimin e anulimit ne teresi te projektit.

Ne letren standarde per tenderuesin e eliminuar keni shkruar:

> ARSYETIM
> *[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar]* për këto arsye :ju mungojn ;
>
> **Kapaciteti teknik dhe profesional:**
>
> **Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300.000,00 € (referenca e juaj ka vlerën prej 256,891.00€.**

Ky eliminim eshte shume jo profesional dhe ne kundershtim me te gjitha dispozitat ligjore te LPP-se dhe me vendimin e OSHP-se te dates 09.10.2020 me nr. 654-702/19.

Ne vendimin e panelit shqyrtues shprehimisht shkruan:

Dhe se OE ankues vetëm ne kontratën të cilën e keni përmendur "Ndërtimi i Rrugës Bujar Roka" sipas referencës e përmbushin këtë kërkesë të AK-së, gjersa listën e projekteve nuk e keni të kompletuar (mungon nr. i AP) siç kërkohet, por që AK sipas nenit 72 të LPP-së, mund që të kërkojë informata sqaruese.

Pra, ne vendim shkruan se ne vetem me kete kontrate e plotesojme kerkesen e AK.

Nuk e kemi te qarte se pse AK ndermerr veprime te qellimshme per te bllokuar projektet duke mos dashur implementimin e tyre.
Ne dyshojme se zyra e prokurimit qellimisht eshte duke dashur te deshtoje realizimin e projekteve, apo ka interesa tjera, sepse eshte jashte cdo logjike fillimisht me dal kunder vendimit te OSHP-se e pastaj me na eliminu neve per mungese te referencave kur kemi prezantuar nje liste prej 4.5 milion euro pune te kryera.
Nuk e kemi te qarte se pse fiks jane marr 256,891.00 EURO si pune te ngjashme prej kontrates kur punet pergaditore, punet e germimit, punet e zhavorit punet e betonit sipas paramases e kalojne vleren prej, 331,315.85 Euro, te cilat jane pune identike me ato pershkrime ne paramase.
Per me teper kontrate e ngjashme ndertim i rrugeve eshte edhe projekti Ndertimi - Asfalltimi i rruges ne fshatin Demjan, ku perseri ne kete kontrate jane pune pergaditore, pune te dheut, pune te zhavorit pune te betonit ne vlere prej 123 357.00 €.

Gjeni te bashkangjitur paramasen e projektit te Demjanit

Vetem me keto dy kontrata tejkalohet vlera e referencave e puneve nje per nje te ngjashme siq eshte kerkuar ne kete projekt.
Me kete rast AK ka bere shkelje flagrante te dispozitave ligjore pasi qe na ka eliminuar pa baze, dhe kane dal kunder vendimit te OSHP-se.

Edhe nje here po e bashkangjesim listen e referencave te cilat i ka vertetuar edhe eksperti shqyrtues edhe me vendim te OSHP-se se ne kemi referenca te mjaftueshme. Nuk e kemi te qarte se pse na mungojne keto referenca. Ne ne dosje te tenderit e kemi prezantuar nje liste te kontratave qe ne total arrin vleren prej 4,614,696.31 €, per te gjitha keto kontrata i kemi bashkangjitur edhe referencat.

PROJEKTET KOMPLET:2017-2018-2019

Nr.	Titulli i kontratës	Data e nënshkrimit te kontratës	Data e përfundimit te kontratës	Vlera totale e kontratës	Emri i Blerësit	E-mailli i Blerësit	Numri i tel. te Blerësit
1	"Mirembajtja Dimerore e Rrugeve Nacionale dhe Rajonale per Viti 2018 - Regjioni i Prizrenit 2."	09.01.2018	31.03.2018	€ 260,040.22	M.per Infrastruktur	nexhat.krasniqi@rks-gov.net	039 200 28 538
2	Rehabilitimi me asfalt i rrugeve ne Komunen e Prizrenit	06.01.2016	15.01.2018	€ 319,364.84	KK Prizren	isa.osmankaj@rks-gov.net	038 200 44 704
3	Mirembajtja Verore dhe Dimrore e rrugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves -Regjioni i Prizreni 2-kontrat 36 muajsh -2017	19.11.2014	15.11.2017	€ 705,199.57	M.per Infrastruktur	nexhat.krasniqi@rks-gov.net	038 200 28 538
4	Ndertimi-Asfaltimi i rruges ne fshatin Demjan-Kontrat	29.08.2013	12.09.2018	€ 516,206.51	KK Gjakove	albana.bakalli@rks-gov.net	038-200-44041
5	Ndertimi i rruges Bujar Roka -pjesa jugore e qytetit ne Gjakove	01.06.2017	21.11.2017	€ 753,695.76	KK Gjakove	albana.bakalli@rks-gov.net	038-200-44041
6	Asfaltimi i rrugeve neper fshatrat e Komunes se Malisheves Lot 2	18.06.2018	28.09.2018	€ 106,245.00	KK Malisheve	malisheva2010@hotmail.com	029 - 269/476
7	Mirembajtja Verore dhe Dimrore e rrugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves -Regjioni i Prizreni 2-kontrat 36	05.04.2018	31.03.2020	€ 976,288.36	M.per Infrastruktur	nexhat.krasniqi@rks-gov.net	038 200 28 538
8	Mirembajtja Verore dhe Dimrore e rrugeve Nacionale dhe Regjionale te Republikes se Kosoves -Regjioni i Prizreni 2-kontrat 36	05.04.2018	31.03.2019	€ 977,656.05	M.per Infrastruktur	nexhat.krasniqi@rks-gov.net	038 200 28 538
		SHUMA TOTALE		€ 4,614,696.31			

SH. DRINI COMPANY SHPK PRIZREN

Deshmi: Lista e kontratave dhe referencave e dorezuar ne Tender, si dhe paramasat per projektin e Ndertimit te rruges qarkore Bujar Roka qe ka vlere 753 695.75 € dhe rruga e fshatin Demajn 516,206.51 €

Te gjitha keto pozicione nje per nje gjenden ne te gjitha paramasat e projekteve te realizuara nga ana e jone.

Kerkojme nga OSHP qe ankesen tone ta aprovoje si te bazuar dhe lenden ta kthen ne rivleresim pasi qe nuk ka kurfar kuptimi eliminimi i jone per mungese te referencave, dhe njeherit ta urdheroje AK qe te zbatoj vendimet e OSHP-se.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankuesit "Matcal Solutions"SHPK:

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 64 - Dëshmitë e kërkesave
Neni 66 - Përshtatshmëria Profesionale
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Gjerësa Pretendimet e OE ankuesit të dytë "Construmax"SHPK:

Të nderuar autoriteti kontraktues në njoftimin mbi vendimin e AK-së të dt.30.10.2020 pas kthimit të lëndes në rivlersim, ku neve na ka shpallur si tenderues i eliminuar, ndërsa e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit me arsyetimin se nuk ka oferta te përgjegjshme dhe nuk i përmbushin kushtet e njoftimit për kontrate.

AK-ja në letrën standarde për tenderues të eliminuar edhe pas kthimit në rivlersim nga OSHP-ja përsëri jemi eliminuar për të njejtat arsye kinse ne nuk kemi plotësuar kërkesën Kapaciteti teknik dhe profesional:

- **të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton3. me kiper**
- **një eskavator I tonazhit të mesëm deri 1o ton (eskavator ton i madh)**
- **OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.**

Ju sqarojmë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë nga ky aktivitet i prokurimit nuk qëndron për arsyet si në vijim:
Pretendimi 1: Kompania jonë supozon që nuk qendron arsyeja e eliminit të kompanis tonë kinse nuk kemi në pronësi paisje teknike së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 - 10 tonë me kiper, Kompania jonë ka dorzuar së bashku me dokumentacionin e ofertes tek **folderi 7.1 Makineri**

- **Imri Krasniqi** — Libreza e kamioni me tonazh 8.2 tonë me regjistrim deri 04.09.2020 (hapja e ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)
- **Isuf Misini** - Libreza e kamioni kiper me tonazh 8.1 tonë me regjistrim deri 31.07.2020 (hapja e ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)
- **Ebk shpk-** Libreza e kamioni kiper me tonazh 5.05 tonë me regjistrim deri 06.05.2021 (hapja e ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)
- **Shaban Aliu** - Libreza e kamioni kiper me tonazh 5.57 tonë me regjistrim deri 20.06.2021 (hapja e ofertave ka qenë 20.07.2020 dmth kamioni ka regjistrim)

Andaj arsyeja e eliminimit është totalisht e pabaze, pasi që jo vetëm që ne i kemi 4 kamion a ndërsa kërkesa ka qenë 2 kamion dmth dyfishin e kërkuar plotsojme.

Pretendimi 2: Kompania jonë supozon që nuk qendron arsyeja e eliminit të kompanis tonë kinse nuk e kemi një eskavator I tonazhit të mesëm deri l0 ton (eskavator ton i madh), pasi që është dorzuar me ofertë tek **folderi 7. Makineria - seti Comercv-6.2 Bagerat 5 cope-** ku mbrenda kesaj fajlli në **faqen e 16** është dudi

doganor me nr reference doganore **R 11616** që dëshmon Eskavator i perd me zingjir gime me peshë **5.5 tonë** i tipit VQLVO tipi EC55B viti i prodhimit 2006.
Andaj arsyeja e eliminimit është totalisht e pabaze, pasi që përpos disa eskavatoreve të dëshmuar kemi ofruar edhe dëshmi që kemi edhe eskavator prej 5.5 tone i prodhimit Volvo tipi EC 55 B 2006.

Pretendimi 3: Kompania jonë supozon që nuk qendron arsyeja e eliminit të kompanis tonë kinse OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesi ose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.
Kompania jonë ka dorzuar së bashku me oferte **folderin 9. Autorizimi nga prodhuesi** - ku mbrenda është Autorizimi nga prodhuesi **Europa shpk me NIPT J62903258L nga Shqipria** ku jemi autorizu nga ky prodhues që ka dëshmu në autorizimin e tijë që është i certifkiuar më këto standarte dhe koperon më kompani tjera ndërkobëtare më standarte tjera.
Andaj konstatojm që ne kemi ofru dëshmi Autorizimin e Prodhuesit sipas kërkesës në dosje të tenderit, ndërsa në rast që Autoriteti Kontraktues ka dashur dëshmi tjera shtes do të duhej konform nenit 72 të kërkoj sqarime edhe pse ka pasur dëshmi të mjaftueshme që kemi autorizim nga prodhuesi me këto standarte.

Pretendimi 4: OE **NNT Etniku** nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së tek Kapaciteti teknik dhe profesional. Ky OE është i papërgjegjshëm për faktin se nuk ka ofruar dëshmi që ka në pronësi ose posedim këto pajisje teknike: **a)** së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton3. me kiper **b).** një eskavator I tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda të cilat nuk janë adekuate për këtë projekt. Gjithashtu ky OE nuk ka prezantuar autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i rrethojave metalike nga materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461, mirëpo ka prezantuar një marrëveshje për të cilën nuk ka dëshmi që është Kompani e certifikuar apo distributor, andaj edhe është i papërgjegjshëm dhe Pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin e këtij OE.

Pretendimi 5: OE N.N. " **Inginering MSH " TOSI - V " SH.P.K.** është i papërgjegjshëm për faktin se nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ky OE ka kryer punime te ngjashme 60% të vlerës si lider.
Po ashtu ky OE nuk ka arritur të paraqes dëshmi që ka në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a). së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton3. me kiper **b.** një eskavator i tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda që nuk janë adekuate për këtë projekt. Ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i rrethojave metalike nga materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461. OE ka paraqit vetëm një a test te materialit në një kompani që nuk i ka certifikatat të cilat janë kërkuar dhe pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin të këtij OE.
Gjithashtu ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së përkatësisht tek kapaciteti ekonomik dhe financiar ku kërkesë ka qenë "Operatori ekonomik duhet të ofroje dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjatë tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qene prej jo më pak se 400.000,00 €", ndërsa si dëshmi është kërkuar "Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës." Lideri i konzorciumit të lartpërmendur nuk i ka ofruar dëshmitë se e plotëson këtë kërkesë andaj edhe është i papërgjegjshëm.

Pretendimi 6: **"Puna" Sh.p.k** nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e EDT-së tek Kapaciteti teknik dhe profesional. Ky OE është i papërgjegjshëm për faktin se ky OE nuk i ka ofruar dëshmitë në lidhje me

qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit.
Gjithashtu ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka kryer punë te ngjashme sipas kërkesës së dosje të tenderi edhe pse ka paraqitur disa referenca private, mirëpo nuk ka ofruar dëshmi bankare që janë ekzekutuar vlerat e tyre. Po ashtu ky OE nuk ka arritur të paraqes dëshmi se ka në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike **a.** së paku 2 kamion të tonazhit nga5 10 ton3. me kiper **b.** një eskavator i tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda të cilat nuk janë adekuate për këtë projekt.
OE i lartcekur nuk e ka ofruar autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i rrethojave metalike nga materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461. Ky OE ka paraqitur vetëm një a test te materialit nga një kompani që nuk i posedon certifikatat e kërkuara dhe pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin të këtij OE.

Pretendimi 7; **N.T.P; B-Ademaj** është i papërgjegjshëm për faktin se marrëveshjet e prezantuara për stafin profesional i ka te paraqitura për një projekt tjetër "Ndërtimi i objektit te ri te shkollës ne fshatin Pllanjane.
Gjithashtu ky OE nuk ka arritur të paraqes dëshmi se i ka në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike **a.** së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton3. me kiper **b.** një eskavator 1 tonazhit të mesëm deri 10 ton, mirëpo ka paraqitur makineri më të rënda që nuk janë adekuate për këtë projekt.
Ky OE është i papërgjegjshëm edhe për faktin se ka të paraqitur autorizimin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i rrethojave metalike nga materiali çelik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461 dhe pajtohemi me arsyen e AK-së për eliminimin të këtij OE.

Pretendimi 8: **GOE Matcal Solutions & Drini Company** është i papërgjegjshëm pasi që nuk ka dëshmi që e plotson kërkesën në dosje të tenderi **„Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % kërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale të referencave të natyrës së kontratës"** dhe bartësi I grupit nuk ka arrit të dëshmoj asnjë referencë.
Po ashtu ky GOE nuk ka dëshmi as që e plotsojn vlerën e referencave prej 300.000 € dhe pajtohemi me eliminimin e këtij konzerciumi nga AK-ja.

Pretendimi 9: të gjithë OE tjerë janë të papërgjegjshëm dhe pajtohemi me eliminimin e tyre nga AK-ja

Pretendimi 10: Ne me dt. 09.11.2020 kemi marrë përgjigje në kërkesën për rishqyrtim ku autoriteti kontraktues ka hudhur poshtë si e jashtëafatshme është e paqëndrushme pasi që ne kemi dërguar kërkesën **për rishqyrtim me datë 04.11.2020 në ora 15:56** ndërsa sistemi nëse e ka vonuar procesimin duhet sqaruar nga e-prokurimi, edhe pse Autoriteti Kontrkatues ka mundur të shqyrtoj kërkesat për rishqyrtim pasi që nuk është e cekur në nenin 108/A ditë pune mirpo kërkesa për rishqyrtim duhet të bëhet mbrenda 5 dite pas Vendimit që dmth që ditë kalendarike që përfundojn në oren 0:00 dhe ka pasur afat kohor edhe 8 orë. Edhe nëse do të llogaritej ditë pune atëher kemi pasur afat edhe 2 ditë tjera për arsye të dites së shtune dhe të diel. Andaj bazuar që kërkesa për rishqyrtim konform nenin 108/A duhet të bëhet më së largu 5 ditë pas Vendimit, me të pa drejt AK ka hudhur si të jashtëafatshme kërkesën për rishqyrtim.

Neni 108/A
Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit **prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës** ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.

Andaj nuk ceket ditë pune e as ora mirpo ceket 5 ditë pas dates, që dmth data ndërrohet në ora 00:00 (12:00 i mbramjes) dhe kemi pasur afat deri në oren 00:00 edhe pse ne kemi dorzuar në ora 15:56 mirpo supozojm që sistemi i e-prokurimit e ka vonuar.

Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura shihet qartë se kërkesa jonë për rishqyrtim është e bazuar dhe arsyetimi i AK-së për refuzimin e kërkesë tonë për rishqyrtim nuk qëndron.
Duke u bazuar në të gjitha sqarimet që i kemi cekur më lartë, rezulton se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik, sepse asnjëra nga kushtet e parashikuara në këto dispozita nuk janë përmbushur.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët** sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si operator ekonomik, edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë, nuk jemi shpallur fitues të këtij tenderi por po shihet se qëllimi i AK-së është që ne mos të shpallemi fitues të këtij tenderi. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha **aspektet përmbajtjesore** të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.
Gjithashtu autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe dëshmitë që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, ankesa e OE **"Construmax" SH.P.K** si e bazuar
ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM,**
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.
Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues "Construmax"SHPK:

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Njoftimi për kontratë (kriteret):

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: **3. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 400.000,00 €**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: **Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300.000,00 € Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri I projektit I cili duhet të jetë ingjinjer I diplomuar I**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve.** **Dëshmija 2 Në pikën a. diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose**

ndërtimtarisë ose master me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion - Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës. Kërkesa 3.. Të ketë së paku 10 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton3. me kiper b. një eskavator I tonazhit të mesëm deri 1o ton. OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461. Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % lërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale të referencave të natyrës së kontratës.	**e bashkëpunimit me OE në fjalë. Dëshmija 3. Lista e të punësuarve e paraqitur në ATK në tre muajt e fundit bashk me përshkrimi I shkurtër I vendit të punës për stafin, ose kontratat e bashkëpunimit në të cilat duhet të ceket titulli i këtij projekti si dhe vlefshmëria së paku sa kohzgjatja e realizimit të këtij projekti . pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhet të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre DUD ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve Dëshmija 4. autorizimi nga prodhesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

1.Grup i Operatorëve Ekonomik: N.N. " Inginering MSH " TOSI - V " SH.P.K.Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300.000,00 € kontratës të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton3. me kiper b. një eskavator I tonazhit të mesëm deri lo ton. OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461. Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % lërkesave ekonomiko financiare dhe teknike e profesionale të referencave të natyrës së kontratës.

2. N.P.T. "Bamirs";Kërkesa 3.. Të ketë së paku 10 të punësuar me profesione të ndryshme adekuat për realizim të kontratës të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton3. me kiper b. një eskavator I tonazhit të mesëm deri lo ton. OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.

3. " Puna" Sh.p.k.Kërkesa 3.. Të ketë së paku 10 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton3. me kiper b. një eskavator I tonazhit të mesëm deri lo ton.
OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesi ose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.

4. LIQENI VII SHA Dega në Kosovë;OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesi ose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.

5. **GoE; Bajram Gashi B.I & Hysen Sopa B.I - Suharek** ;të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton3. me kiper b. një eskavator I tonazhit të mesëm deri lo ton. OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.

6. **Alboss Shpk;** OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR(1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.nuk hapet folderi;

7. **GoE; Ridvan Elezi B.I & Renelual Tahiri - Prizren** ;OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.

8. **NNt Etniku ; Suharek** të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton3. me kiper b.njc eskavator 1 tonazhit të mesëm deri lo ton.
OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesi ose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.

9. **CONSTRUMAX SH.P.K.**OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.

10. **GOE; Matcal Solutions & Drini Company** ;Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projektcve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 300.000,00 €
11.OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN),saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.

11. **B-Ademaj** ; të ketë në pronësi ose posedim edhe këto pajisje teknike a së paku 2 kamion të tonazhit nga 5 10 ton3. me kiper b. një eskavator I tonazhit të mesëm deri lo ton.
OE duhet te paraqes autorizimin nga prodhesiose distributori i autorizuar I rrethojave metalike nga materiali celik S235JR (1.0038 EN), saldimi sipas EN 15609-1, galvanizimi sipas standardit ISO 1461.

